



Republika e Kosovës * Republic of Kosovo
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 15.02.2024

Nr.09/1408/2024

KONTRATË PËR FURNIZIME

Numri i kontratës¹: 659-24-1031-1-4-7/C495 & KKHE(VM) 24-004-147

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

N.T. "Atlas", (Fatime Curri B.I.) Rr Deshmoret e kombit, Hani i Elezit, me NUI.810301507, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Furnizime me material te ndryshem dhe incizime me rastin e 17 Shkurtit –Ditës së Pavarësisë së Kosovës KKHE-VM-24-004-147
me numër identifikues: 659-24-1031-1-4-7

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Furnizime me material te ndryshem dhe incizime me rastin e 17 Shkurtit –Ditës së Pavarësisë së Kosovës KKHE-VM-24-004-147

No.	Lot
1	Furnizime me material te ndryshem dhe incizime me rastin e 17 Shkurtit –Ditës së Pavarësisë së Kosovës KKHE-VM-24-004-147

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **985.00 €**; [Nëntqind e tetdhjetë e pesë Euro/zero zero centi] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;

(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

(d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

(e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

(f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 4**Komunikimet,**


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës, dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi. përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Avdush Bajramaliu
Pozita:	Zyrtar i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	15.02.2024
Vula:	

Për Ofruesin e furnizimit / Shërbimeve N.T. "Atlas"

Emri:	Fatime CURRI
Pozita:	Drejtoresh
Nënshkrimi:	
Data:	15.02.2024
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 639-24-1031-1-4-7/C495

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitatë këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitatë e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Ferizaj dega në Kaçanik.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Furnizimit është [15.02.2024].
	6.4	Data e Përfundimit është [14.03.2024].
	6.5	Vendi i kryerjes së furnizimit është [Komuna Hani i Elezit- Zyra e.]
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është [N/A].
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% në ditë për shërbime dhe furnizime të padorezuara Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është [10%] të cmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: N/A
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë [shëno shumën] b) Përgjegjësia e Palës së Tretë [shëno shumën] c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve [shëno shumën] d) Përgjegjësia profesionale [shëno shumën] e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës [shëno shumën]
	16.1	Orari i pagesës do të jetë: [Pagesa do të bëhet pas realizimit të furnizimit dhe shërbimit] Pagesa do të bëhet brenda afati ligjor, ne raste specifike në mungesë të buxhetit për këtë kategori nga njesia kerkuese, pagesa do të bëhet sapo mjetet të alokohen -sigurohen]
Parimet e përgjithshme të pagesës	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: [Produktet duhet të jenë konform ofertes, të papërdorura., sipas kërkesës, brenda Periudha Garantuese e Defekteve është [shëno datën]
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit të Elezit ose përmes procedurave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve-procedurat e ndërmjetësimit me pajtimin e të dy palëve
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	[shëno te dyja] a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [specifikoni gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].